

Shkoder me 17.08.2018

DREJTUAR: AKM-TIRANE
PER DIJENI: DRM-SHKODER
NJESIA ADMINISTRATIVE QELEZ, QARKU
SHKODER

LENDA: KERKESE PER PJESEMARRJE NE
ORGANIZIMIN E KONSULTIMIT ME PUBLIKUN DHE
PALET E INTERESUARA PER APLIKIMIN PER LEJE
MJEDISI TE TIPIT B:
PRODHIMI I USHQIMEVE DHE PIJEVE DHE VEPRIMTARITË E
LIDHURA ME TO, ID 7.7,
g. PRODHIMI DHE AMBALLAZHIMIN E PIJEVE JO ALKOLIKE (PRODHIM, AMBALLAZHIM UJI
MINERAL NATYRAL DHE I PIJEVE FRESKUESE ME GAZ DHE PA GAZ)
TE GJITHA INSTALIMET

PERSONI JURIDIK "KOLA" SH.P.K.

ADMINISTRATORI: Z. NIKOLL KOLA

VENDNDODHJA: SHKODER, QELEZ, ZONA KADASTRALE
3092, NUMER PASURIE 902, LAGJIA MARDHNAQ, NJESIA
ADMINISTRATIVE QELEZ, QARKU SHKODER

SUBJEKTI “KOLA” ME PERFAQESUES LIGJOR Z.NIKOLL KOLA MERRET ME AKTIVITETIN: PRODHIMI I USHQIMEVE DHE PIJEVE DHE VEPRIMTARITË E LIDHURA ME TO, ID 7.7,

g. PRODHIMI DHE AMBALLAZHIMIN E PIJEVE JO ALKOLIKE
TE GJITHA INSTALIMET

SUBJEKTI : SUBJEKTI “KOLA” SH.P.K. ME NR. NIPTI J69414313D

ADMINISTRATORI: Z. NIKOLL KOLA

VENDNDODHJA: SHKODER, QELEZ, ZONA KADASTRALE 3092, NUMER PASURIE 902, LAGJIA MARDHNAQ, NJESIA ADMINISTRATIVE QELEZ, QARKU SHKODER

TEKNOLOGJIA ESHTË E THJESHTË DHE TRADICIONALE POR GJITHSËSI DUKE PERDORUR MJAFT MAKINERI TE KOHES DHE CILESORE.

MBETJE TE IMETA QE JANE NE SASIRA TEPER MINIMALE , SI : PLASTMASI ,MBETJE URBANE TE PUNTOREVE, GRUMBULLOHEN NE NJE PIKE TE CAKTUAR DHE DERGOHEN NE VENDIN E CAKTUAR NGA BASHKIA.

TERRITORI DHE AMBIENTI BRENDA DHE JASHTË GJITHMONE I PASTER, I SISTEMUAR DUKE MBJELLE BIME DHE PEME DEKORATIVE. MIREMBAHET ME KUJDES RRJETI I BRENDSHEM I FURNIZIMIT ME UJE DHE ENERGJI ELEKTRIKE SI DHE SISTEMI KULLUES DHE DEKANTUES TE UJERAVE. RESPEKTOHEN RIGOROZISHT RREGULLAT HIGJIENO SANITARE DHE TE SIGURIMIT TEKNIK TE PUNONJESVE TE SUBJEKTIT DHE TE MOS USHTROHET ASNJE NDIKIM NEGATIV NE SHENDETIN E POPULLATES.

DUHET THEKSUAR QE SUBJEKTI KA KOHE QE E USHTRON KETE AKTIVITET NE KETO AMBIENTE DHE NUK KA PATUR ASNJEHERE PROBLEME ME KOMUNITETIN DHE SIPERMARRESIT E ZONES.

TRUALLI NE TE CILEN NDODHET OBJEKTI, SHTRIHET NE NJE TERREN TE RRAFSHET NDERSA PRONA ESHTË E KARAKTERIZUAR NGA NJE SIPERFAQE UNIFORME KU EFEKTI I EROZIONIT NUK ESHTË I NDJESHËM.

PERMIRESIMI URBAN I KESAJ ZONE, E CILA KA PATUR ZHVILLIME MJAFT TE MEDHA E TE SHPEJTA , URBANISTIKE DINAMIKE KOHËT E FUNDIT VAZHDON TE TERHEQ MJAFT INTERESIN E SUBJEKTEVE PRIVAT. HAPSIRA PARA NDERTESES ESHTË E SISTEMUAR DUKE BERE TE MUNDUR REALIZIMIN E NJE IMAZHI PAMOR MJEDISOR SHUME CILESOR, CKA DHE KA NDIKUAR NE PERMIRESIMIN E PAMJES VIZUALE. PERVEÇ INTERESIT EKONOMIK , INVESTITORI KA BERE RREGULLIME ,SISTEMIME TE SHESHIT PARA OBJEKTIT, RRUGEVE, KA KRIJUAR HAPSIRA TE GJELBERTA.

OBJEKTI NDODHET LARG ZONAVE TE MBROJTURA, ARKEOLOGJIKE, SHKOLLAVE, KOPSHTEVE, SPITALEVE ETJ.

TERITORI I ZGJEDHUR ESHTË MJAFT I PERSHTATSHËM PER FUNKSIONIMIN E KETIJ AKTIVITETI DUKE PARAQITUR DISA PERPARESË SI:

- SISTEM PERSPEKTIV TE FURNIZIMIT ME UJE
- SISTEM PERSPEKTIV TE FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE.
- MUNDESI PER ZBATIMIN KOREKT TE PROJEKTIT
- MUNDESI PER NGRITJE TE SISTEMIT TE KANALIZIMEVE DHE SHKARKIMEVE.

POZICIONI I SHESHIT KA TE ZGJIDHURA DISA NGA PROBLEMET QE LIDHEN ME ANEN FUNKSIONALE SI:

- LARGESI TE MJAFTUSHME NGA VENDET E BANUARA.
- PRANE FUQISE PUNETORE.

NGA PIKPAMJA SOCIALE, ZHVILLIMI I KETIJ AKTIVITETI ESHTË FAKTOR PER ZBUTJEN E PAPUNESISE DHE BURIM TE ARDHURASH PER FAMILJET QE JETOJNE DUKE PUNUAR NE KETE SHOQERI.

BRENDA TERITORIT JANE NDERTUAR AMBIENTE TE GJELBERTA.

NE SHESHIN EKZISTOJNE TE GJITHA PAISJET E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE PUNONJESIT JANE TE INSTRUKTUAR KONFORM LEGJISLACIONIT PER KETE QELLIM.

CIKLI I PRODHIMIT ESHTË TERESISHT I MBYLLUR DHE ME KONTAKTE TEPER MINIMALE ME ELEMENTET E MJEDISIT.

ZHURMAT JANE TE PAKTA DHE ATO KRIJOHEN NE MJEDISE TE MBYLLUR DHE TE PERSHTATSHEM DHE NUK DEGJOHET ASNJE LLOJ ZHURME NE AMBJENTIN E JASHEM. TEKNOLOGJIA E INSTALUAR PER VEPRIMTARINE E MESIPERME ESHTË NE PARAMETRA OPTIMALE.

USHTRIMI I KËTIJ AKTIVITETI NUK DO TË NDIKOJË NË CILËSINË E AJRIT TË ZONËS, PASI NUK DO TË KETË SHKARKIME NË AJËR TË GAZRAVE, PLUHURAVE APO TYMRAVE.

NUK PARASHIKOHEN DËMTIME TË FLORËS DHE FAUNËS SË ZONËS, PASI AJO ËSHTË SHUMË E VARFËR.

KA VLERA NORMALE TË TEMPERATURËS DHE TË LAGËSHTISË NË MJEDISET E PUNËS JANË MARRË TË GJITHA MASAT PËR MBROJTJEN NË PUNË NGA AKSIDENTET DHE PËR EVITIMIN E RREZIKUT NGA ZJARRI.

AKTIVITETI ZHVILLOHET KA KOHË QË EKZISTON DHE NUK KA PATUR ASNJE PROBLEM ME KOMUNITETIN DHE NUK KA SHKAKTUAR PROBLEME TË NDOTJES SË MJEDISIT.

ME KËTË RAPORT SIGUROJMË ORGANET PËRKATËSE SHTETËRORE, VENDIM – MARRËSE, SE PROJEKTI I ZBATIMIT DHE TEKNOLOGJIA E PROJEKTUAR ËSHTË BASHKËKOHORE, CILËSORE DHE PLOTËSON STANDARTET E VENDOSURA NGA BASHKIMI EVROPIAN.

AKTIVITETI JONE KA BERE TË MUNDUR ZBUTJEN E PAPUNESISE NE KETE ZONE, DUKE BERE PUNESUAR NJE PJESE TE MIRE TE BANOREVE TE KESAJ ZONE.

NGA PIKPAMJA SOCIALE, ZHVILLIMI I KETIJ AKTIVITETI ESHTË FAKTOR PER ZBUTJEN E PAPUNESISE DHE BURIM TE ARDHURASH PER FAMILJET QE JETOJNE DUKE PUNUAR NE KETE SHOQERI.

NDIKIMET NË MJEDIS

KY AKTIVITET NUK PRITET TË KETË NDIKIM MJEDISOR TË MATSHËM PASI:

- NUK KA PRODHIM TË MBËTJEVE TË RREZIKSHME
- USHTRIMI I KËTIJ AKTIVITETI NUK DO TË NDIKOJ NË NDRYSHIMIN E NIVELIT TË UJRAVE TOKËSORE, NË RRUGËT UJORE DHE NË NIVELIN HIDROSTATIK TË UJRAVE NËNTOKËSORE, PASI NË KËTË ZONËN KU NDODHET OBJEKTI DHE PËRRETH TIJ NUK KA BURIME UJORE NËNTOKËSORE DHE SHPIME TË NDRYSHME HIDROGJEOLOGJIKE QË DO TË MUND TË DËMTOHESHIN NGA KY AKTIVITET.
- NUK SHKAKTON NDOTJE TË TOKËS ME SHKARKIME TË NDRYSHME TË LËNGËTA APO TË NGURTA.
- USHTRIMI I KËTIJ AKTIVITETI NUK DO TË NDIKOJË NË CILËSINË E AJRIT TË ZONËS, PASI NUK DO TË KETË SHKARKIME NË AJËR TË GAZRAVE, PLUHURAVE APO TYMRAVE.
- GJATË USHTRIMIT TË KËTIJ AKTIVITETI NUK DO TË KETË EMETIME TË NDRYSHME KIMIKE TË LLOJEVE TË NDRYSHME.
- NUK PARASHIKOHEN DËMTIME TË FLORËS DHE FAUNËS SË ZONËS.
- ZHURMAT NË MJEDISËT E PUNËS JANË BRENDA NORMËS SANITARE TË LEJUAR, DHE PËR PASOJË AS ZHURMAT NË MJEDISËT E JASHTME NUK PRITET TË KENË NDIKIM NË POPULLATËN PËRRETH. NIVELI I ZHURMES NUK I KALON 55-70 DB(A) GJATE PUNES. KY NIVEL ZHURMASH ËSHTË BRENDA NORMAVE DHE NUK NDIKON NË SHËNDETIN E PUNONJËSVE.
- KA VLERA NORMALE TË TEMPERATURËS DHE TË LAGËSHTISË NË MJEDISËT E PUNËS
- JANË MARRË TË GJITHA MASAT PËR MBROJTJEN NË PUNË NGA AKSIDENTET DHE PËR EVITIMIN E RREZIKUT NGA ZJARRI.
- FENOMENE TË TJERA. VIBRACIONI, NXEHTËSIA, RADIACIONI, NDRIÇIMI VERBUES ETJ. NUK JANË TË PRANISHME.
- TRAFIKU RRUGOR. GJATË KËTIJ AKTIVITETI NUK DO TË KETË NDIKIME NË AKTIVITETIN RRUGOR.
- PROJEKTET E TJERA SI: RRUGËT E REJA, KANALET E UJRAVE TË ZEZA, BANESAT, LINJA TË ENERGJISË, NAFTAË DHE GAZSJELLËS, LINJA TË TELEKOMUNIKACIONIT ETJ.

KONKLUZIONE

NË MATERIALIN E MËSIPËRM SHIHET QARTE SE KA NJË NDIKIM MINIMAL DHE POTHUAJSE I PAPËRFILLSHËM, POR GJITHSESI SUBJEKTI “KOLA” ËSHTË E NDËRGJEGJSHME SE SADO MINIMAL KY NDIKIM DUHET TË MIRË-MENAXHOHET DHE TË BËHEN PERPJEKJE TEKNIKE PËR TË BËRË KËTË NDIKIM ME VLERE ZERO.

AKTIVITETI KONSIDEROHET I PËRSHTATSHËM DHE I PRANUESHËM NË ZONËN E ZGJEDHUR NGA INVESTITORI, PA KRIJUAR PROBLEME MJEDISORE PËR ZONËN PËRRETH.

SUBJEKTI "KOLA" DO TA USHTROJË VEPRIMTARINË NË PËRPUTHJE ME LEGJISLACIONIN SHQIPTAR NË FUSHËN E MBROJTJES SË MJEDISIT DHE DO TË INVESTOJË PËR PËRMIRËSIMIN E MJEDISIT, PUNËS DHE DO TË MIRËPRESI CDO SYGJERIM NË TË MIRË TË CILËSISË SË PUNËS, SI DHE AKTIVITETI KA BËRË TË MUNDUR ZBUTJEN E PAPUNËSISË NË KËTË ZONË, DUKE PUNËSUAR NJË PJESË TË MIRË TË BANORËVE TË KËSAJ ZONE.

AKTIVITETI JONE NE PERPUTHJE ME VKM NR. 419 DATE 25.06.2014 PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE TË POSAÇME PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE MJEDISI TË TIPAVE A, B DHE C, PËR TRANSFERIMIN E LEJEVE NGA NJË SUBJEKT TE TJETRI, TË KUSHTEVE PËR LEJET RESPECTIVE TË MJEDISIT, SI DHE RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR SHQYRTIMIN E TYRE NGA AUTORITETET KOMPETENTE DERI NË LËSHIMIN E KËTYRE LEJEVE NGA QKB-JA , KY SUBJEKT DUHET TE APLIKOJE PER LEJE MJEDISI TË TIPIT B NE AKM-TIRANE.

ADRESA E AKM-SE, KU PUBLIKU MUND TE DERGOJE KOMENTET DHE SUGJERIMET E TIJ, ME SHKRIM APO NE FORME ELEKTRONIKE:

ADRESA: RRUGA "SAMI FRASHERI" NR.4, TIRANE, - TEL/FAX 04 2 371 237
WWW.AKM.GOV.AL

KONFORM TE TE GJITHA AKTEVE DHE PROCEDURAVE LIGJORE NE FUQI I DREJTOHEM AKM-TIRANE PER NDJEKJEN E PROCEDURES KONSULTIMIT ME PUBLIKUN DHE PALET E INTERESUARA PER APLIKIMIN PER LEJE MJEDISI TE TIPIT B:

g. PRODHIMI DHE AMBALLAZHIMIN E PIJEVE JO ALKOLIKE
TE GJITHA INSTALIMET

ADMINISTRATORI

NIKOLL KOLA

TEL: 0685212880

**“KOLA” SHPK
QELEZ, PUKE
NIPT J69414313D**

e-mail: kola95@gmail.com; Cel: +355682020769

**INFORMACION PERSHKRIMOR MBI
IMPIANTET E STABILIMENTIT TE AMBALLAZHIMIT TE UJIT TE
PIJSHEM “MIDA”**

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Stabilimenti i amballazhimit të ujit të pijshëm “Mida” është ndertuar në vitin 2015 dhe është në pronësi të subjektit “KOLA”, me seli në Qelez Pukë.

Terreni i fabrikës ka karakter rural dhe ndodhet në periferi të fshati Mardhnaq, në juridiksionin e njesise Administrative Qelëz, bashkia Pukë.

Zona ku ngrihet stabilimenti shtrihet në një rajon kodrinor dhe sipërfaqja e përgjithshme në dispozicion të objektit 3000 m², truall ky në pronë të subjektit “KOLA”.

Hyrja në zonën e fabrikës bëhet nëpërmjet rrugës automobilistike që lidh qendrën e njesise administrative Qelëz me fshatin Mardhnaq në një distance 5 km nga qendra e njesise administrative Qelëz.

Kordinatat gjeografike të vendndodhjes së fabrikës janë:

X-44 10 073; Y-46 63 448; Z-568m


1. PERSHKRIMI I MAKINERIVE TE INSTALUARA NE IMPIANT

Impianti teknologjik i prodhimit përbëhet nga:

- a) Kompresoret e ajrit të presionit të lartë
- b) Kompresori i ajrit të presionit të ulët
- c) Ftohëse dhe thareset e ajrit
- d) Filtrat e ajrit
- e) Impjanti i ultrafiltrimit të ujit
- f) Impjanti i prodhimit të ozonit
- g) Cisterna e ujit të linjes kryesore
- h) Cisterna e ujit të ultrafiltruar
- i) Cisterna e ujit me ozon
- j) Makineritë e prodhimit të shisheve plastike (PET)


- k) Makineritë e larjes, mbushjes dhe taposjes së shisheve
- l) Makinerija e etiketimit të shisheve
- m) Makinerija e paketimit të shisheve
- n) Printeri i stampimit të datës së prodhimit dhe skadencës

Kompresoret e ajrit të presionit të lartë



Prodhojnë ajër me presion të lartë 1.2/30 bar, i cili shërben për fryrjen e shisheve. Këto kompresorë janë të instaluar në një sallë të veçantë në një ambient të mbrojtur nga reshjet atmosferike, në komunikim të drejtperdrejt me atmosferën. Linja përmban 3 kompresorë të presionit të lartë të cilët vihen në levizje me motor elektrik me fuqi 11 kw/h secili.

Kompresori ajrit të presionit të ulët



Prodhon ajër me presion të ulët 8 bar, i cili shërben për furnizimin me ajër të makinerive të mbushjes, etiketimit, impjantin e ultrafiltrimit dhe makinerinë e paketimit. Ky kompresor është i instaluar në të njëjten sallë me kompresorët e presionit të lartë. Kompresori vihet në levizje me motor elektrik me fuqi 8 kw/h.

Thareset e ajrit



Janë të instaluar në dalje të çdo kompresori të presionit të lartë dhe shërbejnë për ftohjen dhe tharjen e ajrit i cili del i ngrohtë dhe i lageshtë, për shkak të ngjeshjes nga kompresorët.

Filtrat e ajrit



Janë të instaluar në dalje të tharësve dhe ftohësve të ajrit, dhe në hyrje të makinerive të fryrjes së shisheve. Këto shërbejnë për pastrimin e ajrit të komprimuar nga grimcat e vajit të kompresorit apo grimca të tjera të thithura nga atmosfera. Eliminimi i grimcave dhe vajrave është i domosdoshëm pasi prezencën e tyre ndikon në përkeqësimin e cilësisë së shisheve gjatë momentit të fryrjes.

Cisterna hyrese e ujit të linjës



ka një vëllim 2.5m^3 dhe është e instaluar në hyrje të linjës së ujit të pijshëm. Ky rezervuar furnizon impjantin e ultrafiltrimit. Rezervuari është prej materiali inox dhe mbyllet me galexhant i cili ruan nivelin dhe mbyll prurjen e ujit kur rezervuari mbushet.

Impjanti i filtrimit të ujit (ultrafiltrimit)



është i instaluar pas cisternës hyrëse të ujit. Ky impjant largon grimcat dhe bakteriet që mund të jenë në përzierjen e ujit. Këto makineri formojnë në tërësi një impjant të përbërë nga pompa, filtrat, tubacionet dhe rezervuarët. Filtrat e impjantit vetpastrohen automatikisht sa herë hyjnë në punë.

Cisterna e ujit të filtruar



është e instaluar në dalje të impjantit të ultrafiltrimit dhe shërben për mbajtjen e ujit të filtruar i cili nëpërmjet tubave prej inoksi shkon në makineritë e mbushjes së shisheve. Ky rezervuar është prej inoksi me një vëllim 2.5m^3

Impjanti i prodhimit të ozonit



prodhon ozon cili më pas përdoret për dizinfektimin e shisheve PET në makineritë e larje-mbushje-taposjes. Impjanti përbëhet nga kompresori i ajrit pa vaj, ftohës dhe tharës i ajrit, filtratë e ajrit, gjeneratori i prodhimit të oksigjenit, gjeneratori për prodhimin e ozonit dhe një mikseri.

Rezervuari i ujit me ozon




është e instaluar në dalje të impjantit të prodhimit të ozonit dhe shërben për mbajtjen e ujit të ngopur me ozon i cili nëpërmjet tubave prej inoksi shkon në makineritë e mbushjes dhe larjes së shisheve dhe shërben për dizinfektimin dhe larjen e shisheve përpara mbushjes. Ky rezervuar është prej inoksi me një vëllim 2.5m^3

Makineritë e prodhimit të shisheve plastike (PET)




janë të instaluar në një ambient të veçantë dhe shërbejnë për prodhimin e shisheve plastike PET. Në linjë janë të instaluar tre makineri gjysmeautomatike të cilat punojnë me lëndë të pare pipeta PET të gatshme. Dy nga makineritë kanë module të ndërrueshme dhe prodhojnë shishe plastike me vëllim 0,5 dhe 1,5 liter, ndërsa makinerija e tretë ka modul standart për prodhimin e shisheve 6 litershe. Makinerite përbëhen nga furra e ngrohjes dhe moduli i fryrjes së pipetave. Keto makinerite punojnë me energji elektrike dhe kanë një konsum të energjisë elektrike 12 kw/h secila.

Makineritë e larjes, mbushjes dhe taposjes së shisheve



Jane makineri plotesisht automatike që shërbejnë për larjen, mbushjen dhe taposjen e shisheve. Në linjen e prodhimit janë të instaluar dy makineri, ku secila kryen automatikisht tre funksione larje-mbushje-taposje të shisheve. Njera nga makinerite shërben për larjen-mbushjen-taposjen e shisheve 0,5 dhe 1,5 liter dhe tjetra për larjen-mbushjen-taposjen e shisheve 6 liter. Keto makineri kanë secila një konsum të energjisë 3 kw/h

Makinera e etiketimit të shisheve



Sherben për vendosjen e etiketave në shishe të mbushura.

Makineria është e vendosur pas makinerisë mbushëse 0.5l dhe 1.5l. Makinaria punon me kol të nxehtë dhe ben ngjitje automatike të etiketave plastike në shishe 0,5 dhe 1,5 litershe. Kjo makineri konsumon 9 kw/h energji elektrike

Makineria e paketimit të shisheve



Sherben për paketimin e shisheve duke i mbështjellur me plasmas me trashësi 60 – 80 mikrone. Makinaria është plotesisht automatike dhe është e instaluar pas makinerisë së etiketimit. Kjo

makineri ka nje furre ngrohese elektrike e cila konsumon rreth 18 kw/h energji elektrike.

Transportieret e shisheve ne linje (konvejeret)



Sherbejnë per transportimin automatik te shisheve nga njera makineri e linjes tek tjetra, ne varsi te procesit te punes (shih skemen teknologjike). Keto paisje kane ne perberjen e tyre shtratin levizes, elektromotorret me mekanizmin e levizjes, dhe kembet mbeshtetese me regjistrim.

Printeri i stampimit te dates se prodhimit dhe skadences

Për stampimin e datës së prodhimit dhe skadences së produktit është instaluar nje printer special inject-jet I cili gjendet pas makinerise se vendosjes se etiketave.

KAPACITETI I IMPIANTIT:

Impianti ka kapacitet prodhues për shishe 0.5 liter max. 3000 shishe/orë, për shisheet 1.5 liter max. 2000 shishe/orë dhe për shisheet 6 liter 400 shishe/orë.

Prodhimi i shisheve 0.5 liter dhe 1.5 liter nuk mund të kryhet njëkohësisht, por punohet me alternim, duke nderruar atrecaturen (modullet) në perputhje me kerkesat.

Linja 6 litershe punon në mënyrë të pavarur dhe pa ndërrim atrecature.

LENDË E PARË:

Lëndet e para që perdoret gjatë procesit të prodhimit janë:

- Ujë i pijshëm i marrur nga burimi i ujit të pijshëm i Shkalles së Fieres në zonën e Midës në malin e Krrabit, Pukë.
- Pipetat PET, për prodhimin e shisheve që furnizohen nga tregu Italian.
- Etiketa plastike.
- Kol për ngjitje materiali plastik
- Plasmasmas i thjeshtë për ambalazhim.

FURNIZIMI ME ENERGJI

Impianti furnizohet me energji elektrike nga rrjeti kombëtar shqiptar nëpërmjet linjes së tensionit të mesëm 10 kv. Kerkesa për energji elektrike e impiantit është 80kw/h, dhe furnizimi ralizohet nepermjet nje transformatori me fuqi 100 kw.


Nikoll KOLA
Administrator

